



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KE.nr.995/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë – Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, me praktikante Rina Murseli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit “Botek” Sh.p.k, me seli në Prishtinë, me drejtor menaxhues H.A., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokat N.Sh. me seli të zyrës në Prishtinë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokatura Shtetërore me Avokate I.A., për shkak të padisë për borxh, pas mbajtjes se seancës se datës 10.05.2023, për shqyrtim kryesor te çështjes, ne datën 01.06.2023 jashtë seancës mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET NË TËRËSI SI E BAZUAR padia e paditësit Botek Sh.p.k me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës që t’i paguaj paditësit Botek Sh.p.k shumën prej 45,504.00 Euro në emër të borxhit kryesor, me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur nga data 13.11.2014 deri në pagesën definitive të borxhit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- II. DETYROHET e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës që paditësit Botek Sh.p.k t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore për taksën gjyqësore në shumën prej 1,960.00 Euro në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

I. *Historiku i çështjes / pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar, me padinë e parashtruar gjykatës në datën 26.03.2015, ka kërkuar pagesën e borxhit në shumën prej 45,504.00 Euro nga e paditura Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës në emër të Kontratës për Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike për nevojat e Policisë së Kosovës.

Me datë 14.08.2014, paditësja me të paditurën kanë lidhur kontratë për “Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike për nevojat e PK-së” me nr. Identifikues 214-14-044-111, në vlerë

prej 45,504.00 Euro. Paditësi, përmes padisë ka shprehur se në bazë të nenit 2 referuar Kushteve të Dërgesës, afati kohor për dorëzimin e mallit ka qenë 15 ditë kalendarike nga koha e lëshimit të urdhërblërjes nga ana e Autoritetit Kontraktues, dhe lidhur me këtë, me datë 29.09.2014, e paditura - Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, ka lëshuar urdhërblërjen për paditësin Botek Sh.p.k, në shumë prej 45,504.00 Euro.

Tutje, përmes padisë, paditësi ka deklaruar se me datë 13.04.2014 ka dërguar dhe dorëzuar produktin e kontraktuar, pra 13 ditë pas lëshuarjes së urdhërblërjes dhe po të njëjtën ditë paditësi i ka dorëzuar të paditurës fletëdërgesën mbi pranimin e mallit për nënshkrim, por që asnjëherë nuk i është kthyer paditësit e nënshkruar, dhe produktet e kontraktuara dhe të dorëzuara në formë të programeve kompjuterike dhe licencave, janë instaluar dhe janë në shfrytëzim nga ana e të paditurës.

Paditësi me datë 24.10.2014 përmes postës elektronike i ka dorëzuar të paditurës faturën për pagesë për mallin e dorëzuar. Edhe pas disa paralajmërimeve, paditësi ka deklaruar se ende nuk është përmbushur detyrimi nga ana e të paditurës që rrjedh nga kontrata e lartcekur.

Paditësi, me datë 05.05.2015 ka paraqitur parashtresë për precizimin e padisë, ku përveç të lartpërmendurave ka shtuar se me datë 22.04.2015, përmes postës elektronike ka pranuar nga e paditura Vendimin mbi Ndërprerjen e Njëanshme të Kontratës me nr. Reference DDSH 08-0-4-063 të datës 21.04.2015, për “Furnizimin me licenca dhe programe kompjuterike për nevojat e Policisë së Kosovës. Gjithashtu me datë 24.04.2015, përmes postës elektronike paditësi është njoftuar nga e paditura për Kërkesën dërguar “Sigma – Viena Insurance Group” për Konfiskimin e Sigurimit të Ekzekutimit të Policës së Sigurimit të Kontratës së Prokurimit në shumë prej 10,949.40 Euro, të deponuar nga ana e paditësit Botek Sh.p.k.

Paditësi ka shtuar se nga ana e tij kontrata e lartpërmendur është përmbushur në tersi, dhe produktet e kontraktuara funksionojnë 100%, prandaj e kundërshton shkëputjen e njëanshme të kontratës nga ana e të paditurës, pra sipas pretendimeve të paditësit të dyja veprimet si shkëputjen e njëanshme të kontratës, ashtu edhe konfiskimi i garancionit janë veprime në kundërshtim me ligjin.

E paditura ka paraqitur përgjigje në padi me datë 30.11.2015, dhe përmes saj ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesën e saj si të pabazuar. E paditura ka deklaruar nëpërmjet kësaj parashtrese se lëndë kryesore e kontratës ka qenë furnizimi me licenca dhe programe kompjuterike në Policinë e Kosovës e ku kompania Botek Sh.p.k, si autoritet kontraktues nuk iu ka përmbajtur kushteve esenciale të kontratës në aspektin e dorëzimit të certifikatës së origjinës të furnizimeve konform specifikacioneve teknike të dosjes së Tenderit të Kontratës në fjalë, dhe si pasojë e kësaj edhe ka ndërmarrë veprimin me të cilën ka ndërprerë në mënyrë të njëanshme kontratën.

Pas shqyrtimit të padisë, shqyrtimit gjyqësor dhe shkresave të lëndës, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, përmes Aktgjykimit Ek.nr. 139/2015 të datës 06.07.2018 ka vendosur në aprovimin në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Botek

Sh.p.k, ashtu që të detyrohet pala e paditur Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës t'i paguajë paditësit Botek Sh.p.k me seli në Prishtinë, shumën prej 45,504.00 Euro në emër të borxhit kryesor me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data 13.11.2014 deri në pagesën definitive të borxhit, të gjitha në afatin partitiv prej shtatë ditëve, llogaritur nga pranimi i këtij aktgjykimi, dhe gjithashtu ka detyruar të paditurën t'ia paguajë paditësit shpenzimet procedurale në shumën prej 527.50 Euro. Kjo gjykatë, aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit e kishte mbështetur në tre fakte vendimtare dhe siç janë përshkruar në aktgjykim dhe atë: pala paditëse me kohë e ka njoftuar se vendi i origjinës së furnizimit me licenca dhe programe kompjuterike është Irlanda, pala paditëse me kohë ka kërkuar interpretimin e nenit 3 të Kontratës së datës 14.08.2014 nga Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik, e cila ka dhënë versionin e saj me datën 13.05.2015 dhe me pastaj pala e paditur ka pranuar dhe ka përdorur programet kompjuterike të instaluar nga paditësi nga data 24.10.2014 deri më datën 21.04.2015, kur edhe në mënyrë të njëanshme e kishte shkëputur kontratën.

Ndaj këtij aktgjykimi, e paditura ka parashtruar ankesë brenda afatit ligjor të cilën Gjykata e Apelit me aktvendim e ka aprovuar si të themeltë ankesën e palës së paditur dhe e kishte prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë Ek.nr. 139/2015 i datës 06.07.2018, duke dhënë vlerësimin e saj se aktgjykimi në fjalë ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ku fillimisht dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten, aktgjykimin në fjalë kishte shkelje të nenit 8 të LPK-së, meqë gjykata shkalës së parë nuk ka vlerësuar të gjitha provat veç e veç dhe të gjitha së bashku, por në mënyrë të njëanshme ia ka falur besimin më tepër deklarimeve të palëve se provat materiale. Po ashtu Gjykatës së shkallës së dytë, kishte konstatuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka vërtetuar faktin që paditëse e ka njoftuar me kohë të paditurën se vendi i origjinës së furnizimit me licenca është Irlanda, edhe përkundër faktit se e paditura ka deklaruar se e ka shkëputur kontratën me paditësin me arsyetimin se nuk është përmbushur detyrimi kontraktues nga dispozita kontraktuese – sepse paditësi si furnizues nuk e ka prezentuar certifikatën e origjinës së furnizimeve.

Palët ndërgjyqëse janë thirrur në seancë përgatitore me datë 23.03.2023 ku paditësi përveç të lartpërmendurave është deklaruar edhe rreth vendimit të Gjykatës së Shkallës së Dytë, dhe ka shpjeguar të gjitha faktet dhe çështjet të cilat janë ngritur nga ana e kësaj gjykate duke ju përmbajtur udhëzimeve të kësaj gjykate. Paditësi, në këtë seancë ka shpjeguar edhe një herë rastin kronologjikisht dhe ka shtuar se paditësi kishte njoftuar me kohë të paditurën për vendin e origjinës që ishte Irlanda, e që kishte bashkangjitur edhe dokumentacion përkatës nga prodhuesi i licencave DELL ku e njëjta kompani përmes shkresës zyrtare të dorëzuar me datë 27.10.2014 konfirmon se të njëjtat janë licenca origjinale të cilat janë prej kompanisë DELL të prodhuara në shtetin e Irlandës.

Palët ndërgjyqëse gjatë shqyrtimit gjyqësor, respektivisht paditësi, ka deklaruar se e paditura njëanshmërisht e ka shkëputur kontratën. Duke ju referuar nenit 3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës ku thuhet se furnizuesi duhet të dorëzoj certifikatën e origjinës së furnizimeve, po ashtu në nenin 3 par. 2 ku theksohet se origjina e mallrave duhet të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkimit Evropian ose sipas Marrëveshjes Ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë - për këtë çështje paditësi i ka dorëzuar me kohë të paditurës certifikatën e origjinës

së produktit. Padiësi tutje ka deklaruar se me rastin e shqyrtimit nga ana e policisë, ata kanë thënë se kjo tregon origjinën e produktit kurse ne kemi kërkuar origjinën e furnizimeve. Në kuptimin ligjore origjina e furnizimeve do të thotë origjina e prodhuesit, e për këtë padiësi edhe ka kërkuar nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik interpretimin e dispozitës së origjinës të nenit 3 të kontratës dhe ata përmes e-mail-it kanë shprehur se konform nenit 87 par.2 nën par.8 të Ligjit për Prokurim Publik, KRPP ka ofruar interpretimin e paragrafit 1 të nenit 3 të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës si në vijim: “ kërkesa e nenit 3, par.3.1 është qe furnizuesi do të dorëzoj një certifikate të origjinës se furnizimeve më së voni kur kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Certifikatat e origjinës (CO) është një dokument për të vërtetuar vendin e prodhimit të mallrave”.

Padiësi është deklaruar edhe rreth vendimit të Gjykatës së Apelit, ku ka shprehur se lidhur me vërejtjet e kësaj gjykate se dokumenti i prodhuesit Dell qe padiësi ka dorëzuar me te cilin konfirmohet se vendi i prodhimit te licencave është Dell nga Irlanda dhe se në Aktgjykimin e Gjykatës së Shkallës së parë nuk është konstatuar se ai i përmbush kriteret nga neni 3 i Kushteve të Kontratës, lidhur me këtë padiësi ka deklaruar se kjo provë e dorëzuar e cila gjendet në shkresat lëndës e sqaron dhe e përmbush në plotëni nenin 3 të kushteve të kontratës të cilit ju ka referuar më lartë. Sipas gjykatës së Apelit kërkohet nga gjykata e Shkallës së Parë të konstatohet dhe të sqarohet se shkëputja e kontratës është bërë në përputhje apo në kundërshtim të kushteve të kontratës, po ashtu e njëjta gjykate ka konstatuar se nëse vërtetohet fajësia e shkëputjes se kontratës në mënyrë të njëanshme atëherë lindë e drejta për të kërkuar kompensim në këtë rast kërkesa është kompensimi për dëmshpërblimin e vlerës se produktit sipas kontratës e përcaktuar sipas kërkesëpadisë.

Pala e paditur gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se edhe më tej e konteston padinë dhe ka shtuar se Rekomandimet e Gjykatës së Apelit janë po ato të cilat edhe i kanë cekur gjatë shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar me herët në gjykatën paraprake, respektivisht Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik, andej edhe bazuar në këtë i ka propozuar gjykatës që padinë e padiësit Botek Sh.p.k ta refuzojë si të pabazuar.

II. Administrimi i provave

Deklarimet e të autorizuarit të padiësit, deklarimet e përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha, një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8, të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK). Në kontestin e përgjithshëm të procedurës provuese lidhur me faktet vendimtare për përcaktimin e rrethanave të kësaj çështje kontestuese, gjykata i është referuar provave të administruara si në vijim:

1. Kontrata me nr. ... e datës 14.08.2014;
2. Sigurimi i ekzekutimit;
3. Polisa e sigurimit me nr.
4. Plani për menaxhimin e kontratës e datës 14.08.2014;
5. Urdhërblerja e lëshuar nga MPB-ja e datës 29.09.2014;

6. E-mail-i i datës 24.10.2014 për konfirmim për instalimin me sukses të licencave me nr. 44666 dhe faturave përkatëse;
 7. Fatura me nr. 131014/1 e datës 13.10.2014;
 8. Deklarata e përfaqësuesve të kompanisë BOTEK Sh.p.k i datës 02.10.2017;
 9. E-mail-i i datës 13.10.2014 për licencë;
 10. E-mail-i i datës 17.10.2014;
 11. E-mail-i i datës 16.10.2014;
 12. Transferi i datës 02.10.2014;
 13. Njoftimi i datës 27.10.2014;
 14. E-mail-i i datës 17.11.2014;
 15. E-mail-at e datave 10.11.2014, 05.11.2014, 11.11.2014, 24.10.2014;
 16. Vendimi për ndërprerjen e njëanshme të kontratës;
 17. Referenca negative për mos-përmbushje të kontratës e datës 24.04.2015;
 18. Vendimi i AKI-së për kredibilitetin e kompanisë me nr. ref 06-516-2015 e datës 02.09.2015;
 19. Kërkesa për interpretimin ligjor i KRPP-se e datës 13.05.2015;
 20. Aktvendimi i Gjykatës së Apelit AE.nr.230/2018 i datës 04.06.2020.
- Nga Kontrata me nr. ... e datës 14.08.2014, gjykata konstatoi se Kontrata është Kontratë Publike Kornizë, e lidhur mes këtu palëve ndërgjyqëse. Kjo kontratë është lidhur për kohë të caktuar, dhe atë nga data e nënshkrimit të palëve e deri në kalimin e prej një periudhe 24 mujore (13.08.2016). Neni kontestues, konkretisht Neni 3 parasheh që: *“furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës”*. Neni 26 i titulluar “Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues”, parasheh që Autoriteti Kontraktues mundet që pasi t’i jap Furnizuesit 7 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në disa raste, por ai kontestues nga Gjykatat paraparke ka qenë nën a), ku kjo parashihet në rast se furnizuesi në mënyrë përmbajtësore nuk arrin t’i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontratë. Gjithashtu, kjo gjykatë nga Kontrata në fjalë, vërejti se paragrafi 3 i po këtij neni parasheh që dhe citoj: *“Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t’i zvogëluar në minimum shpenzimet”*.
 - Nga Sigurimi i ekzekutimit, gjykata vërtetoi se Polica nr. ..., të lëshuar nga Signa Vienna Insurance Group, në emër të Botek Sh.p.k, dhe për policinë e Kosovës, është garancion me kërkesë të parë ku operatori ekonomik, në këtë rast Botek Sh.p.k ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, dhe me anë të këtij garancioni është konfirmuar se Kompania e Sigurimit në fjalë do të jen garantues në emër të operatorit ekonomik në vlerë prej 10,949.40 Euro, dhe me kërkesën e parë me shkrim nga Autoriteti Kontraktues do të i paguhet, dhe atë nëse Autoriteti Kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive objektive se Operatori Ekonomik (tutje paditësi) ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i

ka shkaktuar dëme Autoritetit Kontraktues (këtu të paditurës), dhe në rast se Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i kësaj kanë mbetet pa npaguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve. Pagesa prej 10,949.40 Euro, në bazë të këtij garanconi do të bëhet pa asnjë kundërshtim e as ankesë.

- Nga Plani për Menaxhimin e Kontratës e datës 14.08.2014, konstatohet se ky plan është përgatitur nga A.S., për Furnizim, në vitin buxhetor 2014. Në këtë plan janë dhënë të dhëna për ngjarje / rezultate të kontratës.
- Nga Urdhërblerja e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e datës 29.09.2014, vërtetohet se urdhër blerja ka qenë për Botek Sh.p.k, kërkuar ka qenë MPB-ja – Shërbimet e Mbështetjes, Artikull ka qenë SOFTËER, në sasi të përshkruar 0.499, me çmim të njësisë 91,130.39, dhe total në shumë 45,504.40 Euro. Në rubrikën e Udhëzimeve Speciale, është shënuar ‘Sasia 1600’.
- Nga E-mail-i i dt. 24.10.2014 për konfirmim për instalimin me sukses të licencave me nr. 44666 dhe faturave përkatëse, kjo gjykatë vërtetoi se Drejtuesja e Projektit në emër të Botek Sh.p.k, ka lajmëruar menaxherin e prokurimit të Autoritetit Kontraktues (tutje referuar si “AK”) I.C. nëpërmjet e-mail-it, se stafi teknik, respektivisht menaxherët e projektit nga ana e dy palëve, përfundimisht me datë 24.10.2014 kanë përmbyll me sukses Instalimin e të gjitha licencave sipas UB me nr. 44666. Gjithashtu më tej, përmes këtij e-mail-i është shprehur se Botek Sh.p.k ka qenë përgjegjës vetëm për liferimin e këtyre licencave, dhe pasi stafi i MPB-së kanë hasur në vështirësi gjatë instalimit të licencave, ata (nënkuptohet Botek Sh.p.k) kanë qenë të angazhuar sëbashku edhe me personat përgjegjës të vetë prodhuesit DELL për instalimin e tyre të plotë dhe me sukses. Përmes këtij e-mail-i, në fund është bashkangjitur edhe fatura përkatëse, dhe është kërkuar MPB-ja që të informojë Botek Sh.p.k, kur janë gati që të jua sjellin faturë në original.
- Nga Fatura me nr. 131014/1 e datës 13.10.2014, gjykata konstatoi se është lëshuar faturë për produktet si në vijim: për produktin me përshkrim ‘MessageStats’ në sasi prej 1600 copë, me çmim 6.76 euro; për produktin me përshkrim ‘Spotlight for Active Directory Pack’, në sasi 1600 copë, në çmim 7.62 Euro; dhe për produktin me përshkrim ‘Spotlight on Messaging’, në sasi 1600 copë dhe me çmim 10.14 Euro – të tëra këto në total 45,504.00 Euro me TVSH.
- Nga Deklarata e përfaqësuesve të kompanisë BOTEK Sh.p.k e datës 02.10.2017, BOTEK i është referuar Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit Ekonomik duke shpejguar në mënyrë kronologjike tërë procesin, duke filluar nga data 27.03.2014 kur Botek ka marrë një autorizim formal për pjesëmarrje në tender në atë kohë nga distributori i autorizuar, kompania “Grey Matter”, më pas kur është nënshkruar kontrata në mes Botek dhe Autoritetit Kontraktues për tenderin “Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike për nevojat e PK-së”, e deri me datën 02.10.2017 kur me kërkesën e Autoritetit Kontraktues është insisitur dëshmimi i vendit të blerjes dhe

originës së licencave, pra në këtë rast paditësja Botek i ka përcjellur Policisë së Kosovës SWIFT e pagesës së këtyre licencave tek distributori Q-East Software si dhe konfirmimin e prodhuesit DELL ku konfirmohet qartë se licencat e instaluar janë me origjinë nga prodhuesi DELL Software International – Irlandë.

- Nga e-mail-i datës 13.10.2014, gjykata konstatoi se Projekt-Menaxheri i Botek Sh.p.k përmes këtij e-mail-i i ka dërguar A.S. nga Policia e Kosovës se licencat për projektin “Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike” dhe nr. Ref 214/14/044/111.
- Nga e-mail-et i datës 16.10.2014, Policia e Kosovës (tutje referuar si “PK”), përkatësisht menaxheri i kontratës A.S. ka njoftuar BOTEK-un lidhur disa probleme që janë rastis në lidhje me instalimin e Software-it. Në e-mail të datës 17.10.2014 projekt-menaxheri i Botek i ka shpjeguar edhe një herë procedurën e një instalimi të suksesshëm në lidhje me licencat “QUEST”, dhe e ka ftuar edhe një herë që në rast nevojë t’a kontaktojë. Në kundërpergjigje të këtij e-mail-i A.S. nga PK-ja, ka shprehur se do t’i instaloj sipas radhës së shprehur nga e-mail-i nga BOTEK-u dhe do ta njoftojë kur të përfundon.
- Nga ‘Njoftimi’ i datës 27.10.2014, konstatohet se ‘DELL Software’ (Menaxheri i Përgjithshëm) i ka dërguar letër/njoftim Policisë së Kosovës, nëpërmjet të cilës ‘lajmëron’ se DSFT CYPRUS LIMITED është zyrë lokale partner e DELL Software për territorin e Kosovës për të shitur dhe distribuuar produktet e DELL Software, gjithashtu për të ofruar shërbimet e mirëmbajtjes për të njëjtat. Përmes kësaj letre ka cekur se licencat kanë origjinë nga Dell Software International Ltd Irlandë.
- Nga e-mail-i i datës 14.11.2014, kjo gjykatë vërtetoi që menaxheri i kontratës A.S. i është referuar BOTEK-ut duke i shprehur se ekziston mosperputhje mes dosjes së tenderit – ofertës dhe dokumenteve që dëshmojnë origjinën e furnizimeve. Në dosje të tenderit është autorizimi me të cilën dëshmohet se furnizimi do të bëhet nga Grey Matter Ltd ndërsa në dokumentet e prezentuara pas takimit të datës 10.11.2014 është dëshmuar që furnizimi është bërë nga Kompania Q-East Softwares S.R.L, andaj në bazë të kësaj BOTEK është lajmëruar që furnizimet sipas kontratës në fjalë nuk mund t’i pranojë dhe rrjedhimisht edhe ka ndërprerë kontratën.
- Nga e-mail- i i datës 17.11.2014, vërtetohet që BOTEK i është referuar Drejtorit të Administratës, Drejtorit të Departamentit të TI-së dhe Drejtorit të Departamentit të Prokurimit lidhur me mos-pajtimin e tij për e-mail-in e lartpërmendur të datës 14.11.2014, për arsye se BOTEK i ka dorëzuar të gjitha dokumentet dhe sqarimet e nevojshme. BOTEK përmes këtij e-mail-i ka shpjeguar edhe një herë faktet duke filluar nga data 23.04.2014 kur kanë marrë autorizimin për pjesëmarrje në tender nga kompania “Grey Matter”, tutje me datë 14.08.2014 është nënshkruar kontrata për “Furnizim me licenca dhe programe kompjuterike për nevojat e PK-së”, duke vazhduar tutje me datë 28.10.2014 përmes e-mail-it me emër ‘Dell Software DSFT Letter 17.10.2014’, kompania Dell pas ndryshimeve të brendshme ka autorizuar kompaninë DSFT Cyprus Limited për distribuim të Software-it për Evropën Lindore në emër të prodhuesit DELL.

Në vazhdim të këtij e-mail-i, ndër të tjerash, BOTEK ka shprehur dyshime për manipulime të fakteve sepse KRPP nuk mund të jep mendim në kundërshtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe Kushteve të Kontratës.

- Nga e-mail-i i datës 24.09.2014, konstatohet që zyrtari nga PK-ja ka lajmëruar BOTEK-un se pagesa do të ekzekutohet në momentin e raportit të pranimit nga Njësia e Kërkesës, përkatësisht A.S.. Nga e-mail-i i datës 28.10.2014, BOTEK përkatësisht projekt-menaxheri L.K. ka përcjellur konfirmimin zyrtar rreth origjinës së produkteve të liferuara nga ana e tyre (vendi i origjinës Irlandë). Nga e-mail-i i datës 29.10.2014 BOTEK i është referuar PK-së lidhur me disa kërkesa paraprake të tyre për procedura doganore, dhe kështu BOTEK i është përgjigjur se nga dokumentet nga Departamenti i Doganës nuk është e detyrueshme të krijohet DUD-i për Software – blerje online, kjo duke ju referuatur Këshillës Ligjore të datës 11.10.2013. Në të njëjtën kohë BOTEK ka shprehur që blerjet dhe kjo shitje në vecanti janë deklaruar në Librat Përkatës të blerjeve dhe shitjeve.
- Nga e-mail-i i datës 05.11.2014 PK-ja ka shprehur që pranimi i licencave nuk është bërë ende dhe ka kërkuar nga BOTEK që të dokumentojë origjinën e furnizimeve. Nga e-mail-i i datës 10.11.2014 BOTEK ka deklaruar që sipas marrëveshjes në takim të po të njëjtës ditë, pra, 10.11.2014, ju ka dorëzuar të gjitha dokumentet shpesh të kërkuara nga PK-ja, ku edhe morrën konfirmimin e PK-së, dhe ka rinjoftuar edhe njëherë se prej datës 24.10.2014, Policia e Kosovës ka Software-in funksional dhe sipas dosjes së tenderit dhe presin nga Policia e Kosovës konfirmimin për pranimin e mallit dhe nënshkrimin e faturës.
- Nga Vendimi për ndërprerjen e njëanshme të kontratës i datës 21.04.2015, kjo gjykatë gjeti se PK-ja ka marrë vendim për ndërprerje të njëanshme të kontratës pas paralajmërimit të datës 07.04.2015, me arsyetimin që autoriteti kontraktues nuk iu ka përmbajtur kushteve esenciale të kontratës në aspektin e dorëzimit të certifikatave të origjinës së furnizimeve, dhe si pasojë Policia e Kosovës është detyruar që të shkëpus kontratën.
- Nga Referenca negative për mos-përmbushje të kontratës e datës 24.04.2015, kjo gjykatë vërtetoi që Policia e Kosovës ka lëshuar këtë letër me arsyetimin që BOTEK ka sjellë certifikatë krejt tjetër të origjinës e cila nuk përputhet me ofertën teknike të dosjes së tenderit. Kështu, duke marrë parasysh jo korrektësinë dhe mashtrimin, siç i është referuar z. I.C.j nga PK-ja, Policia e Kosovës ka lëshuar këtë letër reference negative për marrjen e ndonjë kontrate pranë Autoritetit Kontraktues.
- Nga Vendimi i AKI-së për kredibilitetin e kompanisë me nr. ref 06-516-2015 e dt. 02.09.2015, kjo gjykatë vërtetoi AKI ka marrë vendim që Operatori Ekonomik Botek Sh.p.k pajiset me Leje të Sigurisë Industriale për Nivelin Sekret, kjo me arsyetim që në bazë të kërkesës së Policisë së Kosovës për zhvillimin e procedurës së verifikimit të sigurisë së Operatorit Ekonomik, departamenti në fjalë i AKI-së ka ndërmarrë veprimet procedurale konform Ligjit për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e

Sigurisë, dhe në këtë rast Operatori Ekonomik i lartcekur paraqet rrezik të pranueshëm për sigurinë e RKS.

- Nga Kërkesa për interpretimi ligjor i KRPP-së e datës 13.05.2015, u vërtetua që KRPP i ka kthyer përgjigje Botek-ut lidhur me interpretimin e nenit 3 të Draft Kontratës, ku ka shprehur që nga ky nen, certifikatë e origjinës (CO) është një dokument për të vërtetuar vendin e prodhimit të mallrave.
- Nga Aktvendimi i Gjykatës së Apelit AE.nr.230/2018 i datës 04.06.2020, kjo gjykatë vëretetoi që Gjykata e Apelit ka aprovuar ankesën e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës dhe ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, dhe kështu ka kthyer këtë çështje në rivendosje dhe rigjykim. Gjykata e Apelit këtë vendim e kishte bazuar në disa fakte, fillimisht Gjykata e Apelit ka shprehur që gjykata paraprake pa e vërtetuar plotësisht faktin nëse paditësi Botek Sh.p.k, me të vërtetë ka prezentuar certifikatën e origjinës çka edhe e ka shty Policin e Kosovës në shkëputje të njëanshme të kontratës, ka vendos në aprovim të kërkesëpadisë së paditësit. Së dytë gjykata e shkallës së parë nuk ka sqaruar nëse “Njoftimi” i përmbush kriteret për tu konsideruar “Certifikatë e Origjinës”. Më tej Gjykata e Apelit përmes këtij vendimi ka shprehur që gjykata e shkallës së parë nuk e ka sqaruar nëse shkëputja e njëanshme nga ana e PK-së është bërë konform me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me kontratë apo në kundërshtim me to. Gjithashtu, kjo gjykatë në vendim ka shprehur që fletëdërgesat dhe faturat kontestuese nuk janë pranuar nga e paditura dhe gjykata e shkallës së parë fare nuk ka marrë për bazë dhe nuk ka vërtetuar këtë fakt në vendosjen e çështjes.

III. Vendimi i gjykatës

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit të hollësishëm të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, duke bërë vlerësimin e tyre në vështrim të dispozitës së nenit 8.1 dhe 8.2 të LPK-së, Gjykata vërtetoi se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e bazuar.

Nga provat e administruara, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: në mes të palëve ndërgjyqëse nga provat e administruara rezulton se nuk është kontestuese fakti se paditësi Botek Sh.p.k me të paditurën Ministria e Punëve të Brendshme – Policia e Kosovës, kanë qenë në marrëdhënie kontraktuale përmes Kontratës për “Furnizim me Licenca dhe Programe Kompjuterike për nevojat e PK-së” me nr. 214/14/044/111. Kontrata për “Furnizim me Licenca dhe Programe Kompjuterike për nevojat e PK-së” është lidhur nga palët me datë 14.08.2014, dhe ka qenë në vlerë 45,504.00 Euro, po ashtu në kontratë ishin paraparë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta me të cilat ishin paraparë – kontraktuar të gjitha detyrimet dhe përbushja e tyre rreth këtij kontraktimi.

Gjykata ka konstatuar që në bazë të kësaj kontratë, përkatësisht nga Kushtet e Vecanta, pika 8.1, paditësi është detyruar që të paguajë shumën e sigurisë së ekzekutimit në 10% të vlerës së

kontratës – 10,949.00 Euro. Kjo gjykatë gjithashtu ka konstatuar nga e-mail-at e shkëmbyera ndërmjet palëve ndërgjyqëse, të administruara më lart, se palët kanë qenë në gatishmëri në instalim të suksesshëm të mallit të kontraktuar, dhe me datë 24.10.2014, zyrtarja e projektit E.G. i ka dërguar e-mail Policisë së Kosovës dhe personave të tjerë relevant duke përfshirë zyrtarët e prokurimit, për instalimin e suksesshëm të të gjitha licencave, dhe këtu ka bashkangjitur edhe faturën përkatëse.

Pas afërsisht disa dite, gjykata ka gjetur se palët ndërgjyqëse kanë pasur një tjetër shkëmbim e-mail-ve, ku me datë 24.10.2014 nga menaxheri i projektit nga ana e PK-së, përkatësisht A.S. kishte kërkuar nga paditësi dokumentimin e origjinës së furnizimeve. Po të njëjtën ditë, drejtori i prokurimit I.C., e lajmëron paditësin se pagesa do të ekzekutohet në momentin e pranimit nga menaxheri i Kontratës, dhe gjithashtu në të njëjtën e-mail e lajmëron paditësin se fatura nuk do të pranohet.

Më tutje paditësi ju ka drejtuar drejtorit të prokurimit dhe menaxherit të projektit nga PK-ja se e-mail ku i ka bashkangjitur konfirmimin zyrtar rreth origjinës së produkteve të liferuara, ku vendi i origjinës është Irlanda, dhe kështu tutje ka ardhur deri tek problemi i tërë këtij kontesti, ku nga ana e të paditurës kontestohet se tërë kohën është kërkuar origjina e furnizimeve dhe jo origjina e prodhimit, ku këtë më pas sipas pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, gjegjësisht paditësit, dokumentet shitesë të kërkuara i ka dorëzuar në takimin e datës 10.11.2014, ku më pas e paditura ju ka përgjigjur nëpërmjet e-mail-it që ‘Furnizimi’ që kanë dëshmuar në takim është në kundërshtim me autorizimin që kanë për këtë projekt. Ky shkëmbim e-mail-ash ka vazhduar tutje ku paditësi me datë 11.11.2014 i ka shpjeguar të paditurës që Operatori Ekonomik nuk është i detyruar t’i blejë apo furnizohet direkt nga prodhuesi dhe faktin që nuk janë Autoritetet Kontraktuese ato që ua caktojnë OE se ku duhet t’i blejnë produktet që janë objekt kontrate. Në këtë e-mail edhe një herë ka konfirmuar që produktet / licencat e liferuara janë 100% sipas temave teknike të tënderit dhe ofertës së paditësit, origjinal të shkarkuara nga ana e të paditurës, nga prodhuesi DELL (direkt) dhe 100% konform kontratës.

Për Gjykatën përveç provave tjera të administruara me lartë si prova me relevance në vendosjen e kësaj çështje kontestuese ishin provat si në vijim: 1. ‘dealer’-it të autorizuar nga DELL që nga data e ofertimit deri tek data e nënshkrimit të kontratës ka qenë “Grey Matter”, e që më pas për distribuim të Software-ve si distributorë i këtyre Software-ve që ishte bërë “DSFT CYPRUS LIMITED”, pastaj prova nr. 13 e administruar me larët me të cilën konstatohet se përmbushen kriteret për t’u konsideruar “Certifikatë e origjinës” dhe se ky dorëzim i këtij ‘Njoftimi’ i kishte përmbush kërkesat e nenit 3 të Kontratës. Kjo gjykatë vendosi t’ia fal besimin provave të paraqitura, respektivisht provave nr. 13 dhe 19 të administruara më lart, nga ana e paditësit ku ka dokumentuar përmes paraqitjes së Njoftimit nga Menaxherja për mbështetje të rinovimeve nga DELL Software, znj. Sorina Radu që DSFT CYPRUS LIMITED është partner lokal i zyrës së DELL Software për territorin e Kosovës dhe origjina e tyre është nga Irlanda.

Gjithashtu duke marrë parasysh faktin që sipas nenit 3 të Kontratës kërkohet që furnizuesi të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve, dhe në bazë të e-mail-ave të shkëmbyera konfirmohet që me datë 24.10.2014 është konfirmuar Instalimi i Suksesshëm i Software-ve, ndërsa me datë 27.10.2014

daton ‘Njoftimi’, kjo gjykatë konstaton se ‘Njoftimi’ kontestues, i përmbush kriteret edhe për t’u konsideruar “Certifikatë e Originës” dhe rrjedhimisht plotëson edhe kërkesat nga neni 3 i Kontratës.

Po ashtu është fakt se shkëputja e njëanshme e Kontratës ishte bërë nga ana e të Paditurës-Policisë së Kosovës, megjithatë për Gjykatën, kontestuese ka qenë fakti nëse kjo shkëputje është bërë në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara me kontratë apo në kundërshtim me të. Sa i përket kësaj, Gjykata duke ju referuar Vendimit të lëshuar nga ana e Policisë së Kosovës me datë 21.04.2015, me të cilin Vendim ishte konstatuar se e paditura ka vendosur në ndërprerje të njëanshme të kontratës me arsyetimin se pala tjetër, në këtë rast paditësi Botek Sh.p.k nuk iu është përmbajtur kushteve esenciale të kontratës më aspektin e dorëzimit të certifikatës së origjinës së furnizimeve konform specifikaciveve teknike të dosjes së tenderit, specifikuat neneve 26 par.1 pika a) dhe nenit 3 par.1 të kontratës.

Sa i përket kësaj çështje të lartcekur, nga provat e administruara kjo gjykatë gjeti se edhe pas dërgimit të ‘Njoftimit’ nga ana e paditësit tek e paditura më të cilën ka vërtetuar atë që parashihet me nenin 3 par.1 të Kontratës, Shkëputja e Kontratës për Furnizim me Licenca dhe Programe Kompjuterike për Nevojat e PK-së, nuk mund të vlerësohet si shkëputje konform kushteve dhe procedurave të kontratës, për vetë faktet që paditësi fillimisht e ka përmbushur kërkesën nga neni 3 par.1 të Kontratës dhe së dyti që shkëputja e Kontratës të lartcekur në mbështetje të nenit 26 par.1 pika a) ka ndodhur gati 8 muaj pas lidhjes së saj – që do të thotë se kontrata ishte shkëputur pas një kohe të gjatë pasi që ishte përmbushur dërgimi (liferimi) i mallit i paraparë me këtë kontratë nga paditësi, ndërsa muaj më vonë për Policinë e Kosovës paska qenë konfuzë interpretimi i ‘Certifikatës së origjinës së furnizimeve’, gjë që Gjykata nuk mund të pranojë një konstatim të tillë lidhur me pretendimet e të paditurës sa i përket konfuzionit lidhur me Certifikatën e origjinës, ngase këtë interpretim e kishte dhënë KRPP-ja.

Po ashtu nga gjendja faktike e vërtetuar gjykata zbatoj nenet 6, 7 dhe 8 të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve (tutje referuar si “LMD”), me të cilët thuhet se palët kontraktuese në marrëdhënie kontraktuese janë të obliguara t’i kryejnë obligimet e ndërsjellta dhe janë përgjegjëse lidhur me përmbushjen e tyre dhe se të kontratat dypalëshe pjesëmarrësit nisen nga parimi i vlerës së barabartë të dhënieve reciproke. Bazuar në këto dispozita edhe e paditura ka qenë e detyruar t’i përmbush obligimet kontraktuese në tërësi ashtu siç është paraparë me dokumentet kontraktuese.

Kjo gjykatë gjithashtu vlerëson se janë zbatuar dispozitat e ligjit material sepse sipas dispozitës së Nenit 106 të LMD-së me të cilin thuhet dhe citoj: *“në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e dëmit”* si dhe nenit 107.2 të LMD-së që thotë *“kreditari mund ta mbajë kontratën në fuqi, në qoftë se pas skadimit të afatit, pa shtyrje e njofton debitorin se kërkon përmbushjen e kontratës”*. Në rastin konkret, konform dispozitave ligjore të sipërcituara meqenëse paditësi e ka përmbushur në tërësi kontratën, dhe meqenëse e drejta e përmbushjes së kontratës është e drejtë themelore, atëherë e paditura në cilësi të debitorit ka për

detyrim që të kryejë pagesën në shumën e përcaktuar si në kontratën “Furnizimi me licenca dhe programe kompjuterike për nevojat e PK-së“.

Gjykata gjithashtu vlerësoi se është zbatuar edhe neni 136 i LMD-së ku thuhet dhe citoj: „*kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*” duke qenë se nga provat e administruara më lart është vërtetuar që e paditura asnjëherë nuk ka paguar faturën dhe në këtë mënyrë edhe i ka shkaktuar dëm paditësit në vlerë prej 45,504.00 Euro.

Vendimin për caktimin e shpenzimeve procedurale si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, gjykata e ka vendosur konform nenit 452 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ndërkaq lartësinë e kërkesës e caktoi sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës – nr. tarifor 6 dhe 7, për këto shpenzime: për taksën gjyqësore në shumën prej 100.00 Euro, për anagazhimin e ekspertit financiar në shumën prej 300.00 Euro, për përpilimin e padisë në shumën prej 208.00 Euro, për 5 seanca të mbajtura (për seancë 270.40 Euro) 1,352.00 Euro, e që në total rezultojnë 1,960.00 Euro.

Nga sa u tha me larte, konform nenit 8 dhe nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi – pika I, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e bazoi në nenin 452 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA KOMERCIALE
Dhomat e Shkallës I - Departamenti për Çështje Ekonomike
KE.nr.995/22, datë 01.06.2023

Gj y q t a r i,
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij Aktgjykimit, Gjykatës Komerciale – Dhoma e Shkallës së dytë, përmes kësaj Gjykate.